

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbime dizenjimi, printimi, materiale promovimi, produkte me qira, si dhe organizime të ndryshme, për nevojat e OST sh.a.”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79952000-2 - Shërbime të organizimit të eventeve

VLERA E FONDIT LIMIT:

10,000,000 (dhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit te Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 4,000,000 (kater milion) Leke pa TVSH.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine, cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, si dhe kohezgjatjen e afatit të marreveshjes kuader, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros së kërkuar të jete në masën 4,000,000 (kater milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të paktën prej 2,000,000 (dy milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të

kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/3 dhe 55/4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërsisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afërsisht 20 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:*

➤ *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 9001: - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës të nevojshëm për realizimin e shërbimeve që kërkohen të ofrohen, të cilët duhet të jenë të*

siguruar, dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-sig per periudhen e 6 (gjashte) muajve te fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Numri i punonjësve të siguruar është vendosur në perputhje me volumin e shërbimit si dhe afatin e ekzekutimit të kontratës dhe ky numër punonjësish është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me sukses të saj. Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në perputhje me specifikimet teknike. Ky kriter është bazuar në nenin 41, pika 4/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Lidhur me stafin që Operatori ekonomik disponon duhet të paraqesë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla. Minimalisht në permbushje të këtij kriteri duhet të ketë në stafin e tij dy persona me arsim të lartë dhe një teknik printimi të certifikuar të pakten 6 (gjashte) muaj të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter lidhet ngushtë me specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar, lidhur me menaxhimin në mënyrë të pavaruar. AK duhet të ketë besueshmëri dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili të përgjigjet me se miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi (fatura blerjeje ose kontrata qiraje) për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion për të përmbushur kontratën. Minimalisht në permbushje të këtij kriteri duhet të ketë makineri profesionale printimi.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Kerkesa që Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese dëshmi (fatura blerjeje ose kontrata qiraje) për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion për të përmbushur kontratën është e lidhur me ngushtë me shërbimin e kërkuar. Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese një profil të kompanisë si dhe metodologjinë dhe strategjinë që ndjek në organizimin e eventeve.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në perputhje me specifikimet teknike, ka besueshmërinë dhe reputacionin për kryerjen e shërbimit objekt kontrate. Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure duhet të paraqese nga një monster për secilin nga artikujt e mëposhtem:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve		Njesia	Sasia
1	Verë së bashku me kuti vere prej druri me printime të personalizuar për dhurata	Verë së bashku me kutinë e verës prej druri me printime të personalizuar për dhurata	copë	1
2	Printim në pllaka druri me imazhe të personalizuar për dhurata	Printim në pllaka druri me imazhe të personalizuar për dhurata	copë	1
3	Kartvizita të personalizuar me logon e OST	Printim kartvizite bazuar në dizajnin e kryer, leter 300 gr, plastifikim mat nga të dyja anet	copë	1
4	Dizenjim pritnim çanta kartoni	Dizenjim pritnim çanta kartoni	copë	1
5	Dizenjim çanta toteBAG me logo	Çanta tekstili me logo të personalizuar, toteBAG	copë	1
6	Dizenjim, Printim Dosje A4	Printim dosje në permasa A4, kallup specifik në varesi të dizajnit, me shpinore, me logo OST	copë	1
7	Dizenjim, Printim Zarfa të personalizuar, 23 x 11 cm	Printim zarfa të personalizuar me logo institucioni të permasës 23 x 11 cm	copë	1
8	Dizenjim, Printim Bllok A5	Bllok me logo OST, format A5, pa kapak, me 20 flete secili bllok, me vijë ose katrore në varesi të kërkesës, leter 115 gr, me karton nga mbrapa për bazament	copë	1

9	Dizenjim, Printim Axshe te personalizuar OST	Dizenjim te axhendes me informacione te pergjithshme (logo + adresa) cdo faqe e brendshme me dizajn dhe logo OST. Printimi i axhendes ne format A5, 388 faqe te brendshme, leter te brendshme mat 90 gr/m2 me 4 color. Kopertina me lidhje speciale me 4 color, plastifikim mat dhe llakim zonal	copë	1
10	Dizenjim, Printim Ftesa	Dizenjim i fteses bazuar ne event. Printimi i fteses ne permasa 20 x 20 cm me palosje, logo OST dhe tekstin specifik.	copë	1
11	Dizenjim, Printim kalendar tavoline	Kalendar tavoline, bazamenti 19 x 35cm, leter 300 gr/m2 super fine me 2 color dhe plastifikim mat, 12 flete ne format 11 x 18cm, me leter 250 gr/m2 me 2 color, Lidhja me spiral teli	copë	1
12	Dizenjim, Printim kartoline	Kartoline me urimet e fundvitit, permasa 20 x 20 cm me palosje, printim 4 color, efekte printimi, leter speciale	copë	1
13	Dizenjim, printim zarfa per kartolina	Zarfa ne dimension 23 x 23 cm, leter speciale per te mbajtur kartolinen e fundvitit	copë	1
14	Dizenjim, printim leter me relief	Dizenjim dhe printim i letres me relief	copë	1
15	Dizenjim, printim leter me varak	Dizenjim dhe printim i letres me varak	copë	1
16	Dizenjim, printim leter me llakim	Dizenjim dhe printim i letres me llakim	copë	1
17	Dizenjim, printim badge + rripa te loguar	Badge printim me material plastik ne printer UV, dimension 8.6 x 5.6 cm + rripa te loguar me logo	copë	1
18	Printim Spila me logo	Printim spila me logo OST/ me permasa te ndryshme	copë	1
19	Stilolapsa te loguar me logon e OST	Printim stilolapsa me logo OST	copë	1
20	Lapsa te loguara me logon e OST	Lapsa 0.7 me logo OST	copë	1
21	Set stilolaps + stilograf per dhurate	Set stilolaps + stilograf me cilesi te larte, me logo OST	set	1
22	Stilograf per dhurate	Stilograf te cilesise se larte me logo OST	copë	1
23	Maska anticovid me logo	Maska anticovid me logo	copë	1

Shenim: Materialet e kerkuara me sipër nuk duhet te kene doemos logon e Autoritetit Kontraktor.

Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me kërkesat e AK dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise,*

Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.